



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr. 1022/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVË, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtarin ligjor Albert Haliti, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit Q.E. pronar posedues faktik dhe juridik i SHPK “C...C...”, fsh ... – Lipjan, drejtor i kësaj ndërmarrje, kundër të paditurit Komuna e Lipjanit, Bordi Komunal për Ankesa, në rigjykim sipas Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.179/2022 të datës 10.11.2022, Dhomat e Shkallës së Dytë të Kësaj Gjykate, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimit, objekt kontesti tatim në pronë, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të paditësit, e në prani përfaqësueses së autorizuar të të paditurit F.M. dhe personit të interesuar G.B. sipas autorizimit për subjektin C...C..., SHPK me seli në Lipjan, me datë 24.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË padia A.nr.1022/22, e paditësit Q.E. pronar posedues faktik dhe juridik i SHPK “C...C...”, Fsh ... – Lipjan, drejtor i kësaj ndërmarrje, kundër të paditurit Komuna e Lipjanit, Bordi Komunal për Ankesa, për shkak të mungesës së interesit juridik, ngase është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.179/2022 të datës 10.11.2022 e ka aprovuar ankesën e paditësit Q.E. pronar i kompanisë “C...C...” SHPK me seli në Lipjan, e ka prishë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal A. nr. 1543/18 i datës 09.01.2020, dhe lëndën i’a ka kthyer gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe rivendosje, me udhëzimin që gjykata në rivendosje të sqaroj se cila është pozita e tij në këtë subjekt (biznesin palë në

procedurë), dhe të sqaroj se a ka autorizim për përfaqësim, etj, si dhe të rregulloj padinë, në kuptim të legjitimitetit real aktiv të palës paditëse.

Kjo gjykatë e dukë vepruar sipas udhëzimeve të Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.179/2022 të datës 10.11.2022, të Dhomës së Shkallës së Dytë, me datën 11.01.2023 ka sjell Aktvendimin K.F. nr. 1022/22, ku këtu paditësit i'a ka kthyer në plotësim padinë me udhëzime që : Të plotësoj petitumin e padisë duke e përcaktuar qartë, kërkesëpadinë në aspektin objektiv, pra se në cilin drejtim dhe vëllim propozohet veprimi ndaj këtij akti administrativ të kundërshtuar, dhe kërkesëpadinë në aspektin subjektiv, pra kush është palë paditëse dhe se cila është pozita e z. Q.E. në raport me biznesin "C...C..."- Lipjan në këtë procedurë; dhe nëse i njëjti posedon autorizimin për përfaqësim të biznesit "C...C..." SH.P.K. – Lipjan.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse me parashtresën e datës 24.01.2023, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në kuptim objektiv dhe subjektiv me propozim që : të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit Q.E. Rr. ..., nr. ... fshati ... – Komuna Lipjan i cili është edhe pronar posedues faktik dhe juridik i SHPK "C...C..." me seli në Fshatin ... Komuna Lipjan, Drejtor i kësaj ndërmarrjeje, dhe të anulohet vendimi i bordit komunal për shqyrtimin e ankesave për tatimin në pronë, si jo ligjor 6 nr. 432-33222 i datës 28.05.2018.

Me datën 07.03.2023, Gjykata duke vepruar sipas udhëzimeve të Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.179/2022 të datës 10.11.2022, të Dhomës së Shkallës së Dytë, ka caktuar seancën gjyqësore në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i paditësit Avokat J.R. dhe i cili ka deklaruar se : Pasi që nuk kam vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës sipas aktvendimit KF.nr.1022/22 të dt:11.01.2023, kërkoj nga gjykata që kjo seancë të shtyhet për të sjellë si provë materiale regjistrimin në ARBK-ë për të dëshmuar pozitën e Q.H. si pronar faktik dhe juridike të subjektit "C...C..." SH.P.K. Është fakt se në parashtresën e datës 24.01.2023 me të cilën jam përgjigjur kësaj gjykate nuk e kam specifikuar qartë kërkesëpadinë në aspektin subjektiv, pra palën paditëse, ngase si paditës duhet të jetë subjekti "C...C..." SH.P.K – Lipjan, e jo Q.H..

Ndërsa në seancën e datës 24.03.2023, për paditësin nuk ka prezantuar askush, ndërsa në cilësi të palës së interesuar është paraqitur G.B.me autorizim nga subjekti C...C...

SHPK – Lipjan e cila ka deklarua se: Autorizimin për përfaqësim e kam marrë nga subjekti ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan, i cili sipas vendimit të të paditurës është ky subjekt që nuk e ka paguar tatimin në pronën e paluajtshme. Aktualisht, nga certifikata e biznesit dhe informatat e biznesit pronar i subjektit ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan është L.H., e ndërkohë që, paditësi Q.E. ka qenë si trashëgimtar i vetëm i kësaj kompanie pas vdekjes së bashkëshortes.

Përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se: Meqenëse, palës paditëse nga gjykata iu ka dhënë mundësia 2 herë që të bëjë rregullimin e padisë në kuptimin subjektiv dhe të bëjë lidhjen në mes të këtu paditësit dhe ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan, gjë të cilën nuk e ka bërë. Tutje, sipas vendimit kontestues subjekt është ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan me pronar L.H., po ashtu edhe kartela financiare është në emër të ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan, me pronar L.H., po ashtu edhe fatura e tatimit në pronë e vitit 2018 është për subjektin ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan, me pronar L.H.. Edhe në bazë të dhënave të fundit nga ARBK, për subjektin ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan, pronar është L.H.. Nga kjo bazë, i propozojë gjykatës që ta hedhë padinë e paditësit Q.E., ngase i njëjti nuk ka as legjitimitet e as ndonjë interes juridik apo faktik në këtë çështje.

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të mbajtur në pajtim me nenin 41 të LKA-së, me datë 24.03.2023, ka nxjerr aktvendim për hedhjen poshtë të paditës së paditësit, në kuptim të nenit 34 par.1 pika 1.3 të LKA-së, për shkak se Gjykata paraprakisht konstatoj se paditësi nuk ka interes juridik që edhe më tutje të vazhdoj ky konflikt administrativ, kjo për arsye se është e qartë se me aktin administrativ të kontestuar me nr.6/432-33222 i dt:25.05.2018 nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj, ngase gjykata paraprakisht vërtetoi se sipas vendimit kontestues nr.6/432-33222 i dt:25.05.2018 subjekt është ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan me pronar L.H., e jo Q.E., tutje kartela financiare e datës 27.04.2018 është në emër të ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan, me pronar L.H., e jo Q.E., e po ashtu edhe fatura e tatimit në pronë e vitit 2018 është për subjektin ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan, me pronar L.H., e jo Q.E.. Ndërsa Gjykata nga leximi i të dhënave të fundit nga ARBK-ja, për subjektin ‘‘C...C...’’ SH.P.K – Lipjan, gjeti se pronar dhe përfaqësues i vetëm i autorizuar është L.H., e nga i cili nuk kemi padi në këtë lëndë të kontestit tregtar administrativ.

Në nenin 34 par.1 pika 1.3 të Ligjit 03/L-2020 për Konfliktet Administrative është parashikuar shprehimisht se *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj”*.

Për këto arsye, e në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 81C të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 34 par.1 pika 1.3 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marrë bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Për këto arsye, e në kuptim të dispozitave ligjore të 34 par 2, lidhur me par.1 pika 1.3 të këtij neni të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.1022/22, datë 24.03.2023

Zyrtari Ligjor

i,

Albert HALITI

\_\_\_\_\_

Gj y q t a r

Fisnik NULI

\_\_\_\_\_

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.